
 Republika e Kosovës Republika Kosovo	Zyra e Personelit Kancelaria za Osoblje		 Komuna e Istogut Opština Istok
	02 Nr.31/19	Datë: 13.02.2019	

Në mbështetje të nenit 13 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenit 12, paragrafi 4, të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe nenit 18 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, Komuna e Istogut shpall :

KONKURS

Për kryerjen e punëve me marrëveshje për shërbime të veçanta

Drejtoria: Drejtoria për Inspektion

Vendi i punës : Inspektor i Veterinës

Nr. i referencës: 20Nr.31 /19

Lloji i pozitës: Marrëveshje për Shërbime të Veçanta -kohëzgjatja 6 muaj

Numri i ekzekutuesve: 1(një)

Orari i plotë: 40 orë në javë

Paga: 400 €

Detyrat dhe përgjegjësit:

- Ndërmerr masa për inspektimin e produkteve të mishit, qumështit, bulmetit dhe produkteve tjera;
- Ndërmerr masa administrative dhe masa tjera ndaj personave fizik dhe juridik duke u bazuar në ligjin mbi inspeksionin e veterinës;
- Bënë hapjen dhe mbylljen e dhunshme të objektit, për qëllime të inspektimit;
- Bënë marrjen e mallit të dyshimtë, apo të prishur ndërsa mallin i cili paraqet rrezik për shëndetin publik e asgjëson si dhe bëjnë tërheqjen e mallit të dyshimtë nga qarkullimi;
- Bënë ndalimin e ushtrimit të veprimtarisë, përkatësisht kryerjen e punëve të caktuara, për kohë të caktuar;
- Bënë ndërmarrjen e veprimeve lidhur me mostrat, kontrollon produktet me qëllim të verifikimit dhe harmonizimit në pikëpamje sanitare në bazë të dispozitave ligjore në fuqi;
- Bënë ndërmarrjen e masave për evitimin e rrezikut për jetë, shëndetin e njerëzve dhe shëndetin e kafshëve apo mbrojtjen e interesit publik;
- Bënë iniciimin e procedurave kundërvajtës dhe ushtron fletëparaqitjen penale si dhe punë të tjera që rrjedhin nga natyra e punës së Inspektorit të Veterinës, si dhe punë të tjera të parashtruara nga mbikëqyrësi.

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim:

Të drejtë konkurrimi në këtë pozitë kanë shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore, të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë

profesionale për kryerjen e detyrave dhe të cilët kanë aftësi fizike, që kërkohen për pozitën përkatëse.

Dokumentet:

- Dëshmi të kualifikimi shkollor: diploma e Fakultetit të Bujqësisë dhe Veterinës, dega e veterinarisë
- Dëshmi mbi përvojën e punës
- Dy rekomandime;
- Dokument identifikimi;
- Certifikata e lindjes apo ekstrakti;
- Certifikata që nuk jeni nën hetime;

Afati i Konkurimit: Konkursi është i hapur tetë (8) ditë kalendrike nga data e publikimit.

Data e shpalljes së konkursit: 13.02.2019 deri më 20.02.2019

Paraqitja e kërkesave : Aplikacionet merren në Qendrën për Shërbim me Qytetar, kati i I-rë, Zyra nr.100 dhe kërkesat e plotësuara dorëzohen personalisht në të njëjtën zyre.

“Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë “

“Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në Nenin 11, paragrafi 3 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës “

- Kërkesat e dërguara pas datës së fundit dhe kërkesat e pakompletuara nuk do të pranohen

Menaxheri i Personelit
Fatmir Bytyçi

